

STATUTI
I SHOQËRISË PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR
“TECH WORK SH.P.K”

Sot me date 06/12/2024 Shoqëria tregtare private me përgjegjësi të kufizuar “TECH WORK SH.P.K”, që këtu e më poshtë do të quhet “Shoqëria”, zotërohet nga ortaku: **Maringlen Leci** i datëlindjes **27/11/1998** shtetas shqiptar, lindur në Laç dhe banues në Tiranë, i cili identifikohet me karte identiteti me numër personal **J81127061A**.

I cili në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë miraton statutin e shoqërisë “TECH WORK SH.P.K”, në bazë të parimeve të mëposhtme:

KAPITULLI I
EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE,
SELIA, TERRITORI

NENI 1
FORMA DHE EMRI

1.1 Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale Sh.P.K., të cilat vijnë përpara ose menjëherë pas emrit të shoqërisë. Kjo shoqëri i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë.

1.2 Emri i shoqërisë është “TECH WORK SH.P.K”, forma dhe emri i shoqërisë mund të ndryshohen me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

NENI 2
BAZA LIGJORE

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithsi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

NENI 3
SELIA



Selia e shoqërisë është në adresën: **Tirane, Rruga e Kavajes, Godina Garden Building, Kati 2, Ap Nr 1A/D/2 & Ap. Nr 1A/D/3 Zn Kadastrale 8210.**

Me adresën e mësipërme do të identifikohet qendra e personit juridik. Me vendim të asamblesë së ortakëve mund të hapen degë, filiale, agjensi ose përfaqësi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarinë shoqëria.

NENI 4 TERRITORI

4.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj lirisht si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Shoqëria mund të krijojë zyra ose përfaqësi të saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyra, filiale ose përfaqesite e shoqërisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të krijohen dhe do të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

KAPITULLI II **OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

5. Shoqëria “**TECH WORK SH.P.K**” ka si objekt kryesor të veprimtarisë së saj: Zhvillim software, platforma dixhitale, ecommerce dhe shitja e programeve kompjuterike për përdorim në fusha të ndryshme. Prodhimi, shitja dhe asistencë e software dhe rrjeteve informatike, mbajtja, riparimi dhe marrja me qira e pajisjeve dhe mjeteve elektronike për perpunimin e të dhenave; menaxhimi i qendrave të perpunimit të të dhenave dhe të rrjeteve informatike të çdo lloji. Përgatitja dhe mirëmbajtja e faqeve të internetit, ofrim domain-esh, shërbime web hosting, shërbimeve të telekomunikacionit, përgatitja dhe mirëmbajtja e rrjeteve sociale në internet si dhe marketing online, mirëmbajtja dhe riparimi i kompjuterave dhe rrjeteve të komunikimit si dhe shërbime të tjera informatike. Lidhur me aktivitetin e përmendur më sipër, në përputhje me legjislacionin në fuqi, mbetet e kuptuar se detyra të tilla profesionale do t'i ngarkohen drejteperdrejte profesionisteve, rregullisht të aktivizuar në varesi të rastit, nën përgjegjësinë e tyre. Hartim dhe implementim projektesh në fushën e teknologjisë së informacionit. Ofrimi i shërbimeve të ndryshme informatike në fushën e teknologjisë së informacionit. Shërbime marketing në fushën e monitorimit të medias elektronike dhe të shkruar.

NENI 6



KOHËZGJATJA

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria priset dhe kalon në procedurë likuidimi me vendim të asamblese së ortakeve, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj.

KAPITULLI III

LIBRI I SHOQËRISË, KONFIDENCIALITETI, DOKUMENTET E DISTINUARA PËR TË TRETËT

NENI 7 LIBRI I SHOQËRISË

Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, shoqëria do të çelë librin e vet, i cili do të quhet libri i shoqërisë.

NENI 8 KONFIDENCIALITETI

Ortakët e shoqërisë si dhe personat e tjere të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhe, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

NENI 9 DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT

Të gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshëm emrin e shoqërisë dhe pas tij fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet “Sh.P.K.”, si dhe emrin e administratorit ose të administratorëve.

KAPITULLI IV

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESËT DHE TRASFERIMI I TYRE



NENI 10 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është : **100,000 Lek** (Njeqindmije lek), zoterues i nje kuote me 100% te aksioneve ortaku **Maringlen Leci**.

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dytë.

NENI 11 TË DREJTAT E ORTAKËVE NË LIDHJE ME KAPITALIN

11.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërise kryhet sipas vendimit të asamblese së përgjithshme të ortakeve, me shumicën e (tre të katërtave) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise.

11.2 Përgjegjësia e ortakeve për detyrimet e shoqërise shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj themeltar.

11.3 Kuotat e kapitalit të shoqërise mund të rëndohen lirisht me barrë siguroese apo të drejta të tjera reale. Në rast shitje të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise për efekt zbatimi të një vendimi gjyqësor apo përmbushje të një detyrimi, enti që ekzekuton vendimin ose detyrimin (zyra permbarimore ose ndonje organ tjetër kompetent), duhet te kete në konsiderate respektimin e kërkesave të nenit 14 të këtij statuti. Secili ortak që rëndon me barrë apo të drejta të tjera reale kuotat e tij, ka detyrimin ti shpjegoje nenin 14 të këtij statuti subjektit në favor të cilit vendoset barra siguroese.

11.4 Secili ortak ushtron të drejtat pasurore të parashikuara nga ligji në proporcion me kuotat e pjesëmarrjes në kapital.

11.5 Ortakët që nuk marrin pjese në administrimin e shoqërisë kanë të drejtë t'i kërkojnë organit administrativ informacione mbi aktivitetin e shoqërisë, si dhe të konsultojnë dokumentet kontabël e dokumentet e tjera që lidhen me administrimin e saj.

NENI 12 FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT

Fusha e autoritetit të ortakëve, përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kenë si kriter bazë kontributin e çdo ortaku ne kapitalin e shoqërisë, si dhe kompetencat që gëzon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuar në këtë statut.

NENI 13 FINANCIMI I SHOQËRISË

13.1 Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të kërkojë nga ortaket fondet e nevojshme për arritjen e objektit të shoqërisë.



13.2 Financimet e mëtejshme të ortakëve do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nepërmjet të cilit jepen këto fonde.

NENI 14 LENIA DHE TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

14.1 Kapitali themeltar i shoqërisë ose pjesë të tij mund të transferohen lirisht mes ortakëve të shoqërisë. Kapitali themeltar i shoqërisë ose pjesë të tij mund të transferohen tek persona të tretë vetëm pasi ortakët e shoqërisë në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar zyrtarisht kanë refuzuar ushtrimin e të drejtës së parablerjes.

14.2 Transferimi i kapitalit themeltar të shoqërisë ose i pjesëve të tij tek persona të tretë bëhet vetëm në këtë mënyrë:

- Oferta për shitje u drejtohet të gjithë ortakëve me shkrim;

- Oferta duhet të përcaktojë numrin e kuotave që shiten dhe çmimin e tyre;

Nëse ortakët e shoqërisë brenda tre muajsh nga oferta me shkrim nuk pranojnë blerjen e kuotave të ofruara me çmimin e kërkuar, atëherë ata konsiderohet se lejojnë shitblerjen tek të tretët.

14.3 Kapitali themeltar është lirisht i trashëgueshëm në rrugë trashëgimie. Bashkshorti, paraardhësit mund të bëhen ortakë nepërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar sipas kushteve që lejohen në ligj.

14.4 Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vertetohen me akt noterial dhe të depozitohen në organin kompetent.

KAPITULLI V ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 15 ORGANET DREJTUESE

15.1 Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë asambleja e ortakëve dhe administratori. Për efekt të ndryshimeve që mund të pësojë shoqëria në të ardhmen dhe shtimit të numrit të ortakëve, këtu e në vazhdim organit zotërues të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë do ti referohemi me termin Asamble e Ortakëve.

15.2 Shoqëria mund të emërojë më shumë se një administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorin e shoqërisë “**TECH WORK SH.P.K**” ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numër.

15.3 Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohëzgjatja dhe kompetencat e tyre.



15.4 Administrator i shoqerise për një periudhë 5 (pesë) vjeçare është Maringlen Leci i datëlindjes 27/11/1998 shtetas shqiptar, lindur në Laç dhe banues në Tirane, i cili identifikohet me karte identiteti me numër personal J81127061A.

KAPITULLI VI **ASAMBLEJA E ORTAKËVE**

NENI 16 VENDIMET E ASAMBLESË TE ORTAKËVE

16.1 Asambleja e ortakëve vendos për çështjet që ligji apo ky statut ia rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, organi administrativ kërkon mendimin apo miratimin e ortakëve.

16.2 Vendimet e zakonshme të asamblesë së ortakëve merren me votën e ortakëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e kuotave të kapitalit themeltar, përveç rasteve kur ligji apo statuti kërkon një shumicë të ndryshme.

16.3 Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 17 KONSULTIMI ME SHKRIM I ORTAKËVE

17.1 Në përputhje me dispozitat e statutit, vendimet e ortakëve mund të merren pas një konsultimi me shkrim që organi administrativ i drejton secilit prej tyre. Në këtë rast, organi administrativ i komunikon ortakëve tekstin e projekt-vendimit që do të merret dhe i kërkon të shprehin vullnetin e tyre në lidhje me këte çështje.

17.2 Vendimet e marra në këte menyrë janë të vlefshme kur vendimi merret nga shumica që ligji apo ky statut kërkon për atë çështje.

NENI 18 MËNYRA DHE VENDI I THIRRJES SË ASAMBLESË SË ORTAKËVE

18.1 Asambeja e ortakëve thirret pranë selisë së shoqërisë, apo në ndonjë vend tjetër brënda apo jashtë Shqipërisë, nepërmjet një njoftimi me shkrim që iu dërgohet ortakëve nga kryetari i asamblesë së ortakëve dhe/ose organi administrativ në e-mail:

- **“leciglenn@gmail.com”** dhe në numër telefoni **0684141901**

18.2 Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së asamblesë duhet të kryhet 15(pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së mbledhjes dhe duhet të përcaktojë shprehimisht datën, orën, vendin si dhe rendin e ditës. Në rast pamundësie apo mosveprimi nga ana e organit



administrativ, mbledhja e asamblesë së ortakëve mund të thirret nga esperti kontabël i autorizuar, nëse ka të tillë, ose nga një apo më shumë ortakë, të cilët përfaqësojnë jo më pak se 10% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 19 KRYETARI I MBLEDHJES SE ASAMBLESE SË ORTAKËVE

19.1 Mbledhja e asamblesë së ortakëve emëron kryetarin e asamblesë.

19.2 Kryetari i asamblesë verifikon thirrjen dhe mbledhjen e rregullt të asamblesë së ortakëve, vërteton identitetin apo legjitimitimin e përfaqësuesit të ortakëve dhe drejton zhvillimin e rregullt të mbledhjes.

NENI 20 PJESËMARRJA NE VENDIME

Çdo ortak ka të drejten e një vote për çdo kuotë të kapitalit themeltar të shoqërisë që ai zotëron. Një ortak mund të përfaqësohet në mbledhjen e asamblesë nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë, nepërmjet një akti përfaqësimi me shkrim.

NENI 21 KOMPETENCAT E ASAMBLESE SË ORTAKËVE

21.1 Asambleja e ortakëve mund të jetë e zakonshme dhe e jashtëzakonshme, kjo në varësi të çështjes për të cilën është thirrur. Vendimet e asamblesë së zakonshme të ortakëve merren vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Vendimet e asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve merren me një shumicë të cilësuar prej 3/4 të votave të ortakëve të shoqërisë. Për çfarë nuk është pasqyruar në këtë nen, asambleja e ortakëve të shoqërisë vendos në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04. 2008, i ndryshuar.

21.2 Kompetencat e asamblesë së zakonshme të ortakëve do të jenë:

- Vendos për përpilimin ose miratimin e rregulloreve për shoqërine apo për fusha e vecanta të veprimtarisë.
- Vendos për ndryshimin e selisë së shoqërisë.
- Vendos për krijimin e zyrave ose të përfaqësive si dhe për krijimin e shoqërive ose të ortakërive me persona të tjere fizike apo juridike.
- Vendos për politiken afariste të shoqërisë dhe përcakton fushat konkrete te veprimtarise së saj.
- Emëron dhe shkarkon me një shumicë të cilësuar prej 3/4 të votave të ortakëve të shoqërisë : administratorin e shoqërise, ekspertin kontabël, likujdatorin duke përcaktuar dhe detajuar kompetencat e tyre, të drejtat, detyrimet, kohëzgjatjen në



detyrë, dhe shpërblimin e tyre.

- Vendos në lidhje me krijimin e organeve të tjera drejtuese që mund ti nevojiten shoqërisë duke përcaktuar në aktet e krijimit të këtyre organeve, kohëzgjatjen dhe kompetencat e tyre, për emerimin e personave drejtues të këtyre organeve.

- Asambleja e ortakëve marrjen e vendimeve e kryen vetë dhe nuk bën delegimin e vendimarrjes te asnjë organ tjetër. Asambleja e ortakëve vendos edhe në lidhje me krijimin e sektorëve te veçante të veprimtarisë së shoqërisë.

- Shqyrton dhe miraton bilancin vjetor, përcakton llojin e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, përcaktimin e dividendit, marrjen dhe dhenien e huave, kredive, borxheve.

- Realizon marrëdhëniet më të rëndësishme ekonomike dhe financiare të shoqërisë me persona te tjere fizik apo juridik, vendas apo te huaj.

- Miraton një tabelë për tarifën e shërbimeve të shoqërisë sipas fushave

- Vendos në lidhje me transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar teshoqërisë.

21.3 Kompetencat e asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve janë:

- Vendos në lidhje me zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.

- Vendos në lidhje me kohëzgjatjen e shoqërisë si dhe për mbarimin e likuidimit të saj.

- Vendos për ndryshimin e emrit të shoqërisë.

- Vendos në lidhje me ndryshimin e statutit të shoqërisë.

- Vendos për ndryshimin e formës, për ndarjen e shoqërisë si dhe përbashkimin e saj me shoqëri të tjera.

21.4 Përveç kompetencave të lartpërmendura, të cilat janë ekskluzive për të, asambleja e ortakëve ushtron çdo kompetencë që ia njeh ligji.

21.5 Asambleja e ortakëve në rastet kur nuk ka emëruar administrator, kryen dhe kompetencat që në këtë statut janë përcaktuar për këtë të fundit. Gjithashtu, asambleja e ortakëve mund të kufizojë administratorin në ushtrimin e kompetencave të tij.

NENI 22

ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

22.1 Kompetencat e administratorit ose të administratoreve, në mënyre konkrete dhe të detajuar përcaktohen në aktin e tyre të emerimit. Veç të tjerave që mund të detajohen në këtë akt, administratori ka edhe këto kompetenca:

- Kujdeset për funksionimin e përditshem normal të shoqërisë ose të një pjese të aktivitetit ekonomik dhe financiar të saj, sipas përcaktimit në aktin e emerimit.

- Përgatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme për gjendjen ekonomike dhe financiare te shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe ia paraqet asamblesë së ortakëve për shqyrtim.

- Kordinon veprimtarinë e personave të punësuar në shoqëri.

- Ndjek problemet e shoqërisë në marrëdhënie me organet shtetërore ose cakton ndonjë prej personelit për trajtimin e këtyre problemeve.



- I propozon asamblesë së ortakëve tarifat e shërbimeve dhe pagat për personelin e punësuar në shoqëri.
- I propozon asmblesë së ortakëve rregulloren e shoqërisë.
- Administratorët kanë të drejtë të gjithë sëbashku ose veçmas nga njeri tjetri të përfaqësojnë shoqërinë në lidhje me të tretët.

22.2 Administratori ose administratorët janë përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë ushtrimit të administrimit të shoqërisë. Përgjegjësia është individuale ose solidare, kjo në varësi të rrethanave dhe të mënyrës sesi është vepruar, pra individualisht ose solidarisht.

KAPITULLI VII

LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI, DIVIDENTET, KONTROLLI KONTABËL

NENI 23 KONTROLLI KONTABËL

Kontrolli i jashtëm kontabël i shoqërisë kryhet nga ekspertë kontabël të autorizuar, sipas legjislacionit në fuqi. Asambleja e ortakëve do të emerojë një apo më shumë eksperte kontabël në ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 24 LIBRAT E SHOQËRISË

Shoqëria është e detyruar të mbaje, përveç librit të shoqërisë, në të cilin shënohen emrat e plotë të ortakëve dhe kapitali themeltar, si dhe vendimet e asamblesë së ortakëve, edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

NENI 25 BILANCI DHE REZERVAT

25.1 Bilanci mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiare dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar, i paraqiten për shqyrtim asamblese së ortakëve, e cila vendos mbi miratimin, ndryshimin ose rrezimin e këtyre akteve, kur e konsideron të nevojshme



asambleja e ortakeve mund te beje rekomandimet e nevojshme ne lidhje me çeshtjen ne diskutim.

25.2 Me mbylljen e secilit vit financiar, administratori i vetem merr masat e nevojshme per hartimin e projekt-bilancit te aktivitetit per vitin financiar te mbyllur, ne menyre qe asambleja e ortakeve te vendose mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve te percaktuara nga ligji.

25.3 Asambleja e ortakeve vendos mbi ndarjen ndërmjet ortakëve të shumave që rezultojne si fitime sipas bilancit të aprovuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme, si dhe të jenë lënë mënjanë shumat e nevojshme për krijimine rezervës ligjore. Rezerva ligjore krijohet vit pas viti nepërmjet lënies mënjanë të një shume të barabarte me 5 % të fitimit neto të realizuar gjatë secilit vit financiar, deri sa të arrihet një shume e barabartë me 10 % te kapitalit themeltar të shoqërisë.

25.4 Asambleja e ortakëve në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave të tjera, si dhe masen e tyre.

KAPITULLI VIII **MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË**

NENI 26 MBARIMI

Shoqëria mbaron me vendim të asamblesë së jashtëzakonshme të ortakeve ose kur ka nje prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

NENI 27 LIKUJDIMI

27.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi asambleja e ortakeve cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

27.2 Në fund të procesit të likujdimit, asambleja e ortakeve vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit.

27.3 Mbas pagimit të kreditorëve asambleja e ortakëve mban pjesën e mbetur të kapitalit që u shperndahet ortakëve.

KAPITULLI IX **MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITA TË FUNDIT**



NENI 28
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarreveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do të angazhohen se do ta zgjidhin me mirëkuptim, dhe ne rast se kjo nuk arrihet gjykata kompetente për gjykimin e mosmarreveshjeve apo konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 29
DISPOZITA TE FUNDIT

29.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, do të aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptarë në fushën e shoqërive tregtare si dhe legjislacioni shqiptar në përgjithësi.

29.2 Ky statut është hartuar ne 2 (Dy) ekzemplare, në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplare fuqi të njëjtë ligjore.

“TECH WORK SH.P.K ”

**Ortaku
Maringlen Leci**

Maringlen Leci
